



Pranuar / Dorezuar Prijemeno / Predato Received / Delivered	29.12.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	8595/2022		1/8



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.971/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.971/2022 të datës 03.11.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër Vendimit nr.1672/2022 të Komisionit për Lëvizjen Brenda Kategorisë/të Agjencisë Kosovare për Akreditim i datës 04.10.2022, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2022, mori këtë;

V E N D I M

- I. Aprovohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.971/2022 e datës 03.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.1672/2022 i Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë të Agjencisë Kosovare për Akreditim i datës 04.10.2022.
- III. Anulohet Lista e kandidatëve të aprovuar e datës 05.09.2022 e nxjerrë nga Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë si dhe Formulari i Vlerësimit dhe Renditjes Përfundimtar për të gjithë kandidatët i datës 21.09.2022.
- IV. Mbetet në fuqi Konkursi i shpallur nga Agjencia e Kosovës për Akreditim i datës 27.07.2022, ndërsa lënda kthehet në fazën e verifikimit paraprak të aplikacioneve të organi i njëjtë.
- V. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II dhe III të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit me datë 27.07.2022 ka shpallur konkursin me numër të Referencës: RN00009495 për pozitën e punës "Zyrtarë i Lartë për Monitorim dhe Vlerësim" në kuadër të Agjencisë Kosovare për Akreditim, ku sipas shkresave të lëndës në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi Agim Blakçori i cili rezultoi se nuk është kandidati i përzgjedhur si kandidatë fitues.

Ankuesi, kundër Vendimit Nr.1672/2022 të Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë/ Agjencisë së Kosovës për Akreditim i datës 04.10.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me datë 03.11.2022 dhe numër protokollit: 6671/2022, me pretendimet ankimore se Komisioni për Vlerësimin e lëvizje brenda kategorisë ka vepruar në kundërshtim me kriteret e konkursit të datës 27.07.2022, si dhe pretendimin ankimore se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 15.11.2022 ka pranua përgjigjen në kërkesë me numër protokollit:7094/2022 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, kurse me datën 16.11.2022 ka pranuar plotësimin e përgjigjes e regjistruar me numër të protokollit 7159/2022.

Me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit, Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin VK.nr.190 të datë 15.12.2022 ka vazhduar afatin e vendimmarrjen lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) dite pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 03.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; CV për Kopja e letërnjoftimit të Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për me numër 4521 i datës 04.04.2016; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për me numër 103 i datës 24.12.2012; Vërtetim i lëshuar nga Komuna e Podujevës për me nr.13-234/22 i datës 10.08.2022; Certifikatë e lëshuar nga Learning Together për Certifikatë e lëshuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës për i vitit 2017 me korrespondencën e bashkangjitur; Certifikatë e lëshuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës për i vitit 2018 me korrespondencën e bashkangjitur; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për me korrespondencën e bashkangjitur; Kriteret e Vlerësimit të Portofolios për Vlerësimi i Përgjithshëm; Certifikatë e lëshuar nga GIZ për i datës 16.12.2014 me korrespondencën e bashkangjitur; Certifikatë e lëshuar nga Learning Together për E-mail zyrtari i dërguar nga drejtuar i datës 09.09.2022; Email i dërguar nga SIMBNJ drejtuar i datës 21.09.2022; Formulari për Vlerësimin përfundimtar për të gjithë kandidatës i datës 14.09.2022; Vendim i lëshuar Agjencia e Kosovës për Akreditim me numër të protokollit 1672/22 e datës 04.10.2022;Pliko e bardhë e datës 03.11.2022, Kërkesa për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6900/2022 e datës 08.11.2022; Përgjigja në ankesë e datës 15.11.2022; Konkursi për pozitën Zyrtar i

Lartë për Monitorim dhe Vlerësim i datës 27.07.2022; Lista e Aplikatëve; Aplikacioni për [redacted] i datës 26.08.2022; Aplikacioni për [redacted] i datës 15.08.2022; Aplikacioni për [redacted] i datës 28.08.2022; Aplikacioni për [redacted] i datës 22.08.2022; Aplikacioni për [redacted] i datës 29.08.2022; Aplikacioni për [redacted] i datës 16.08.2022; Aplikacioni për [redacted] i datës 29.08.2022; Aplikacioni për [redacted] i datës 28.08.2022; Vendim i lëshuar nga Agjencia Kosovare për Akreditim me numër protokollit 1163/2022 i datës 05.09.2022; Vendimi me numër 1171/2022 i datës 06.09.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] për [redacted] i datës 09.09.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted] i datës 09.09.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted] i datës 09.09.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted] i datës 09.09.2022; ; E-mail i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted] i datës 09.09.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] drejtuar [redacted] i datës 09.09.2022; Lista e kandidatëve të aprovuar; Formular individual i vlerësimit nga të gjithë antarët i datës 14.09.2022 prej 1 deri 5 faqe; Formulari i vlerësimit përfundimtarë për të gjitha kandidatët me numër të protokollit 1382/2022 i datës 21.09.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Plotësimi i përgjigjes në ankesë me numër të protokollit 7159/2022 i datës 16.11.2022; Akt emërimi për [redacted] i datës 01.12.2012; Certifikatë e lëshuar nga Agjencia Zvicrrane për Zhvillim, Helvatas Kosovo dhe Sëeden Sverige; Certifikatë e lëshuar nga Development Academy e për [redacted] Shkresë -Ligjeratat e ndjekura; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për [redacted] për periudhën kohore 30 shtator-01 tetor 2015; Certifikatë e lëshuar nga MASHT dhe QPEA për [redacted] e datës 11.10.2008; Certifikatë e lëshuar nga UNMIK për [redacted] Certifikatë e lëshuar nga Kolegji UNIVERSUM për [redacted] i datës 03.03.2019; Certifikatë e lëshuar nga GIZ dhe KEC për [redacted] e datës mars 2018; Certifikatë e lëshuar nga Learning Together për [redacted] Certifikatë e lëshuar nga Learning Together për [redacted] Vendim për emërimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Drejtësisë së Arsimit me numër 02-020/02-0015272/18 e datës 01.03.2018; Vendim për emërimin Drejtorit të Drejtësisë së Arsimit me numër 02-020/05-0001772/19 e datës 09.01.2019; Vërtetim me numër 518/05 i datës 12.01.2010; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për [redacted] i datës 20.12.2017; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për [redacted] i datës 31.01.2022; Kopja e letërnjoftimit për znj. [redacted] Akt emërim për [redacted] e datës 01.04.2017; Diplomë e lëshuar nga BPRAL-PPOHE Kolegji AAB për [redacted] me numër 1330/13 i datës 05.12.2013; Diplomë e lëshuar nga BPRAL-PPOHE Kolegji AAB për [redacted] me numër 2070/19 i datës 10.10.2019; Certifikatë e lëshuar nga United Nations për [redacted] e datës Maj 2004; Certifikatë e lëshuar nga Pro Credit Bank për [redacted] e datës 19.10.2005; Certifikatë e lëshuar nga BSC Kosova për [redacted]; Certifikat e lëshuar nga BQK dhe USAID për [redacted] e datës 01.10.2012; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Financave për [redacted] me nr.59/2017 e datës 07.04.2017; Certifikatë e lëshuar nga USAID, Komisioni regullativ i prokurimit publik, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike për [redacted] i datës 24.10.2018; Vërtetim Punësimi i lëshuar nga CHECCHI për [redacted] e datës 18.04.2016; Letër rekomandimi i lëshuar nga Proex shpk INTEREX Prishtinë për [redacted] e datës 04.10.2017; Vërtetim i lëshuar nga ProCredit Bank për [redacted] me nr.ref.03-207 e datës 11.03.2014; Vërtetim i lëshuar nga ProCredit Bank për [redacted] me nr.ref.03-206 e datës 11.03.2014; Letër reference e lëshuar nga UNMIK për [redacted] e datës 02.11.2012; Vërtetim i lëshuar nga Komuna e Podujevës për [redacted] me nr.13-116/01-0019171/21 e datës 26.02.2021; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë për [redacted] e datës 25.01.2021; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë për [redacted] e datës 01.12.2020; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për [redacted] i datës 27.01.2022; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për [redacted] me numër 4 i datës 12.12.2012; Vërtetim i kopjes nga origjinali me Numër LRP.nr.2359/2022 i datës 28.04.2022; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për [redacted] me nr.276 e datës 30.11.2006; Vërtetim i kopjes nga origjinali me numër LRP.nr.12647/2018 iu datës

31.10.2018; Vërtetim i lëshuar nga Ministria e Ekonomisë për [] e datës 23.06.2022; Kontratë pune për stafin arsimor me afat të caktuar e datës 02.09.2017; Letër rekomandimi i lëshuar nga UNMIK për [] i datës 23.11.2016; Letër reference i lëshuar nga UNMIK për [] i datës 18.08.2003; Letër vërtetimi për punësim i lëshuar nga European Union Rule of Law Mission për [] i datës 04.11.2016; Akt emërim për [] me numër AE.Nr.06/2022 i datës 28.07.2022; Vërtetim i lëshuar nga Trafiku Urban për [] me numër 3138 e datës 11.12.2018; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për [] me numër 96 i datës 23.11.2021; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" i datës 23.11.2021; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për [] i datës 20.01.2021; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për [] i datës 25.01.2022; Kopja e letërnjoftimit; për [] Akt emërim për [] Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për [] me numër 4856 i datës 27.07.2017; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për [] me numër 2157 i datës 10.09.2019; Vërtetim i lëshuar nga Qendra e Studentëve për [] e datës 22.08.2022; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me numër PN.NR/KR.Br 3289/2022 i datës 16.08.2022; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për [] e datës korrik 2017; Letër rekomandimi i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për [] Vërtetim i lëshuar nga Këshilli i Rinis Evropiane të Kosovës për [] i datës 10.09.2016; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike për [] i datës maj 2021; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike për [] i datës mars 2019; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike për [] i datës maj 2018; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike për [] i datës dhjetor 2018; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike për [] i datës nëntor 2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për [] i datës 13.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për [] i datës 11.01.2022; Kopje e letërnjoftimit për []; Akt emërim për [] i datës 01.07.2018; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për [] me numër 6367 i datës 05.04.2016; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për [] me numër 149/2021 e datës 21.04.2021; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për [] me numër 2718 i datës 13.04.2022; Kopja e pasaportës për [] Vërtetim i lëshuar nga Komuna e Podujevës për [] me numër 13-72/2022 e datës 31.03.2022; Vërtetim i lëshuar nga Komuna e Podujevës për [] me numër 13-71/2022 e datës 30.03.2022; Vendim i lëshuar nga Komuna e Podujevës për [] me numër prot. 02-112/02-0024841/2021 i datës 19.03.2021; Akt emërim për [] i datës 01.07.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për [] i datës 30.11.2020; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për [] i datës 30.01.2022; Kopje e letërnjoftimit për [] Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për [] me numër 4860 e datës 11.10.2016; Diplomë e lëshuar nga BPRAL-PPOHE Kolegji AAB për [] me numër 631/2021 i datës 21.05.2021; Letër reference e lëshuar nga Broadcast për []; Dëshmi e lëshuar nga Qendra për Punë Sociale Malishevë për [] me nr.prot.30/1535 e datës 06.12.2021; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Tiranës për [] me numër 1944 i datës 30.05.2019; Vendim i lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me numër ref.6/402 i datës 19.03.2019; Certifikatë Licencimi e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për [] me numër të licencës 499 i datës 28.02.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për [] me numër prot.109 i datës 22.03.2022; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e

Punëve të Brendshme për Certifikatë Licencimi i lëshuar nga Ministria e punës dhe Mirëqënies sociale për me numër të licencës 499/2018 i datës 17.12.2018; Vendim i lëshuar nga Ministria e punës dhe Mirëqënies sociale për me nr.prot.500 i datës 13.12.2018; Certifikatë e lëshuar nga Terre des hommes për datës nëntor 2018; Vërtetim i lëshuar nga Qendra për punë Sociale për me nr.prot.30/561 i datës 30.06.2017; Vërtetim i lëshuar nga Qendra për punë Sociale për me nr.prot.30/500 i datës 07.04.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për i datës 28.01.2019; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për i datës 29.01.2020; Kopje e letërnjoftimit për Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" bachelor për Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" master për Kontratë pune për kohë të caktuar/pacaktuar për me nr.ref.07/1-01R/045/12 i datës 06.06.2012; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për i datës 09.01.2020; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për i datës 06.01.2021; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për i datës 26.06.2018; Certifikatë e lëshuar nga Qeveria e Kosovës për e datës 21.02.2014; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike për i datës janar 2014; Certifikatë e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e policisë për me numër 316/2019 i datës 23.01.2019; Certifikatë pjesëmarrje e lëshuar nga Këshilli Rinor Kosovar për Certifikatë e lëshuar nga IT-training për i datës 03.06.2008; Certifikatë e lëshuar KCSF dhe Qendra kosovare për studime rinore për Vërtetim i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e policisë me numër të referencës 07/1-01SAP-P/6969 për i datës 25.08.2022; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për me numër PN.NR/KR.Br17517/2022 i datës 28.07.2022; Certifikatë e lëshuar nga IT-training për i datës 03.03.2008; Kopje e letërnjoftimit për Akt emërim për me nr.11/03/22 i datës 01.03.2022; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për me numër 2928 i datës 15.11.2013; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për me numër 3081 i datës 01.09.2015; Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me nr.483 për i datës 17.07.2020; Certifikatë e lëshuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për i datës mars 2014; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për me numër PN.NR/KR.Br.15672/2022 i datës 15.07.2022; Vërtetim-Referencë e lëshuar nga Bashkësia Islame e Kosovës për me nr.35/2022 i datës 08.02.2022; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike për i datës mars 2022; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratën Publike për i datës korrik 2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, mbi bazën e shkresave të administruara të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se Agjencia e Kosovës për Akreditim me datë 27.07.2022 ka shpallur konkursin lëvizje brenda kategorisë me numër Reference: RN00009495, për pozitën "Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Vlerësim", ndërsa kërkesat e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

• *Arsimimi i kërkuar: Diplome Universitare nga fusha edukimit, shkencave sociale ose fushave tjera relevante me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (në rastin kur kredit janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fushës e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i diplomës Bachelor.*

• *Kualifikimi të posaçme formale: Përvoja e punës së kërkuar: Se paku dy (2) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilin zhvillohet procedura për plotësim e pozitës së lirë të punës.*

Ndërsa, përveç kriterëve të parapara në konkursin e datës 27.07.2022 kanë qenë të përcaktuara edhe kushtet dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranimit të aplikacioneve sikurse përcaktohet në pikën 2. **Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë:** *“Të jetë nëpunës civil i së njëjtës kategori për të cilën aplikon, të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale, Të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende, Të jetë vlerësuar të paktën “mirë” për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit, Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.”*, ndërsa në pikën 5. **Dokumentacioni që duhet të paraqitet për aplikim:** *“Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; Kopjet e dëshmisë së punësimit, Kopjet e dëshmisë së pranimit, Kopjet e vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit dhe Dokumentet që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende”*.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e administruara të lëndës, gjegjësisht sipas Akt Emërimit të datës 01.12.2012, ka konstatuar se ankuesi ka mbajtur pozitën e punës “Zyrtar i Lartë i Arsimit”, në kuadër të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës, ndërsa i sipas aplikacionit të datës 26.08.2022 konstatohet fakti se i njëjti ka aplikuar në konkursin e numër të Referencës: RN00009495 për pozitën e punës “Zyrtarë i Lartë për Monitorim dhe Vlerësim” të shpallur nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, ndërsa sipas formularit të vlerësimit përfundimtar për të gjithë kandidatët i datës 21.09.2022, ankuesi nuk rezulton të jetë kandidatë i suksesshëm.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i këshillit ka gjetur se sipas listës së pikantëve të datës 05.09.2022 me numër protokoli:1164/2022, në konkursin e lartcekur kanë aplikuar tetë (8) kandidatë, prej të cilëve pas verifikimit paraprak të kryer nga Njësia e Pranimit shtatë (7) prej tyre u janë aprovuar aplikacionet dhe i janë nënshtruar procedurës së rekrutimit, ndërsa njërit prej tyre i është refuzuar aplikacioni për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të konkursit.

Tutje, Kolegji i këshillit ka gjetur se disa prej kandidatëve të cilëve u janë aprovuar aplikacionet në fazën e verifikimit paraprak nuk i kanë plotësuar kriteret formale, kushtet për lëvizje brenda kategorisë si dhe nuk e kanë pasur të kompletuar dokumentacionin e kërkuara në konkursin e datës 27.07.2022, respektivisht ankuesit _____ i ka munguar vërtetimi përmes të cilit dëshmohet se i njëjti nuk ka ndonjë masë të shqiptuar disiplinore e cila nuk është shuar ende në institucionin që është duke punuar, sikurse kandidates tjetër _____ nga shkresat e lëndës të ofruara nga institucioni që ka zhvilluar procedurën e rekrutimit konstatohet fakti se të njëjtës i ka munguar formulari i vlerësimeve në punë për vitin 2021, po ashtu edhe kandidatit tjetër _____ i ka munguar formulari i vlerësimeve në punë për vitin 2021 e që ka qenë ndër kushtet e përcaktuara të konkursit.

Kolegji i Këshillit po ashtu ka gjetur se dy (2) prej kandidatëve të cilët të cilët kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak nuk i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme formale të konkursit të datës 27.07.2022, ngase kandidati _____ sipas Diplomës së datës 30.11.2006 me numër:276 ka mbaruar studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike sikurse në bazë të Diplomës së datës 12.12.2012 dëshmohet se ka mbaruar studimet Master në Fakultetin e Inxhinierisë elektrike dhe Kompjuterike dhe ka fituar titullin akademik profesional Master i Shkencave Kompjuteristike, ndërsa sipas vërtetimit të datës 23.06.2022 i njëjti ka qenë në marrëdhënie punë në Ministrinë e Ekonomisë që nga datat 09.08.2019 në pozitën e punës “Inspektor për Energji Elektrike” ndërsa sipas aktit të emërimit të datës 28.07.2022 i njëjti mban pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Eficiência e Energjisë dhe Bashkëprodhimin” nga rrjedh se kandidati _____ përvojën e punës nuk e ka në fushën e

punës për pozitën të cilën janë zhvilluar procedurat e rekrutimit gjegjësisht për pozitën "Zyrtarë i Lartë për Monitorim dhe Vlerësim" sikurse edhe fusha e studimeve gjegjësisht Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike nuk hynë në kuadër të fushës së shkencave sociale. Po ashtu kandidatja e suksesshme në bazë të kontratës së punës të datës 06.06.2012 konstatohet fakti se është e punësuar në Policinë e Kosovës në pozitën e punës "Asistent Administrativ" me përshkrimin e detyrave të punës "Merr shënime dhe shkresa dhe i shqyrton ato. Shqyrton postën hyrëse dhe përgatit shënime të shkurtra për kryesuesin/drejtorin duke nënvizuar idetë kryesore në dokumente. Përpilon shkresa të thjeshta për përgjigje për dhe në emër të kryesuesit/drejtorit.....", tutje kandidatja tjetër e cila ka verifikuar fazën e verifikimit paraprak andaj mbi këtë bazë konstatohet fakti se kandidatja përvojën e punës nuk e ka në fushën për të cilën është zhvilluar procedurat e rekrutimit e që është njëri nga kriteret e konkursit.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë pretendimeve ankimore të ankuesit sikurse edhe të gjeturave të konstatuara si më lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar depozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës neni 41 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 si dhe paragrafi 3 ku përcaktohet se: "Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. 2.Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon: 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurrim për lëvizjen brenda kategorisë", si dhe neni 45 paragrafi 1 dhe 5 i së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: "1 .Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 5. Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendrike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve" dhe ka ardhur në përfundimin se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me rastin e përfshirjes së kandidatëve në listën e ngushtë të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara të konkursit, kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e neni 38 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafi 4.1 të neni 37 të këtij ligji."

Na se u tha si ma lartë, pos konstatimit dhe shkeljeve të gjetura në fazën e verifikimit paraprak nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Akreditim, shkelje të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material si dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, ka vendosur që të shfuqizojë listën e kandidatëve të aprovuar e datës 05.09.2022 me numër prtokoli:1164/2022 si dhe çdo veprim tjetër procedural apo vendim që rrjedh prej tij, ndërsa lënda kthehet në fazën e verifikimit paraprak të aplikacioneve të kandidatëve, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e verifikimit paraprak të aplikacioneve, duhet të kujdeset që me rastin e përpilimit të listës së kandidatëve të aprovuar të mos i përsëris shkelje e gjetura si në arsyetimin e këtij vendimi. Kolegji i Këshillit marr parasysh rëndësinë e që ka institucionin për rekrutimit e dy pozita të lira si në konkursin e datës 27.07.2022 nuk e kemi anuluar

në tërësi konkursin, por lënda gjegjësisht konkursi i datës 27.07.2022 është kthyer në fazën e verifikimit paraprak të aplikacioneve të kandidatëve nga Njësia e Burimeve Njerëzore.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkak të gjeturave të evidentuara si në arsyetimin e këtij vendimi, e jo për shkak të pretendimeve të tij ankimore se i njëjti ka trajnime më shumë apo përvojë të punës në fushën e arsimit më shumë sesa kandidatit e tjerë, respektivisht ankuesi me rastin e aplikimit në pozitën e kontestuar nuk e ka plotësuar njërin kusht, gjegjësisht nuk e ka dorëzuar dokumentin që dëshmon se nuk ka masë disiplinor të shqiptuar, e cila ka qenë njëra ndër kushtet e konkursit.

Andaj, marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës si dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.971/2022.

Flakron GASHI


Procesmbajtës

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Kosovës për Akreditim;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.